



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 446/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Mitrovicë, paraqitur kundër Komisionerv në Vendvotimin 1102B/04R nw Mitrovicë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Mitrovicë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.11.2013, rreth orës 11:00 në Qendrën e Votimit nr. 1102 B /04R në shkollën fillore në Mitrovicë më datën 03 .11 2013 Nysret Beqiri i lindur më datë 01.05.1975 me nr.personal 1030113370 nga Mitrovica, ka shkuar për të votuar , mirpo të njejtit nuk i është lejuar për të votuar pasi që në robriken e emrit të tij ishte i vendosur nënshkrimi i dikujtë tjetër . konsiderojm se është bërë shkelje e nenit 5 i LZP –së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë, ngase pohimet e lartëcekura nga parashtuesi i ankesës nuk janë objektive, me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, për arsye se nuk është ofruar asnjë dëshmi me të cilën do të vërtetohej një pretendim i tillë ankimorë. PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevant , dhe ne kuptim të nenit 3.6 pika c, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it , prandaj ankesa vlerësohet si e pabazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 446/2013 më datën 07.11.2013.

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*